

**AKT THEMELIMI
DHE
STATUTI I SHOQËRISË**

Sot ne date 13/12/2023

Me qëllim të funksionimit dhe organizimit të shoqërisë si dhe përshtatjes me kërkesat e Ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, është hartuar ky statut i shoqërisë tregtare.

KREU I

Emërtimi, Forma Juridike, Selia, Kohëzgjatja, Objekti, Vula

Neni 1

Emërtimi

- 1.1 Emërtimi i shoqërisë është **“ARSI”**.
Ky emërtim është i vetmi i shoqërisë dhe përdoret në të gjithë regjistrimet, transaksionet, marrëveshjet dhe komunikimet e saj me të tretët apo shtetin dhe është i vlefshëm si jashtë dhe brenda vendit.
- 1.2 **Forma juridike është "shoqëri me përgjegjësi të kufizuar", (SHPK).**

Neni 2

Ortakët Themelues

- 2.1 Janë ortakë themelues të shoqërisë në kushtet dhe me të dhënat e mëposhtme:
 1. **Zj. Marie CYLAKU**, lindur në Berat me datë 19/10/1985, dhe banues në Tiranë, mbajtes i letërnjoftimit me nr 034455689 dhe nr.personal I56019063C, madhor me zotesi të plote për të vepruar.

Neni 3

Selia

- 3.1 Selia dhe zyra qendrore e shoqërisë është në :
"ZK 3266, Rruga Hamdi Sina, Liqeni Thate, Pallati Fz Construction, nr 25, Shkalla 3. Apartamenti 14/5. Farke, Tiranë.
- 3.2 Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyrë përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me Vendim të Asamblesë të Ortakëve.
- 3.3 Shoqëria do të përdore si numer kontakti dhe adresë maili:
E-Mail: Mariegaveli@gmail.com , zyrekontabilitet@gmail.com
Telefon: +355692456461



Neni 4
Kohëzgjatja.

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të **papërcaktuar**.

Neni 5
Objekti i veprimtarisë

5.1. Veprimtari ne fushen :

Real-Estate, shitje, blerje, qeramarje, qeradhenie te pasurive te paluajtshme. Shitje, blerje automjesh te reja, te perdorura, automjete retro, makineri pune.

Import - Eksport dhe tregtimi me shumicë dhe pakicë te mallrave te ndryshme ushqimore dhe industriale. Operacione dhe transaksione te cdo lloji lidhur me importin,eksportin, tranzitim dhe tregtimine mallrave te ndryshme industriale dhe ushqimore te gatshme, gjysem te gatshme apo si lende te pare, pajisje e makineri e pjese kembimi.

Importi – eksporti, shitja me shumicë, pakicë dhe online e pajisjeve elektronike, elektroshtëpiake, elektrike, kompjuterike, kancelarike, pajisje teknologjike, sisteme për përpunimin e të dhënave të të gjitha llojeve, hardware, software dhe të gjithë periferikeve të tyre. Import, eksport dhe tregtim prodhimesh të ndryshme druri, mobilje, orendi, pajisje zyrash. Lëndë të para për industrinë, materiale ndërtimi dhe hidrosanitare, pjesë këmbimi, auto dhe makineri te çdo lloji, mallra industriale, ushqimore dhe të tjera.

Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese (fotovoltaike, eolike, hidrike) te energjise elektrike, te cilat shfrytezojne burimet e rinovueshme te energjise si dielli, era, uji, si dhe i veprave te tyre ndihmese.

KREU II
KAPITALI, KUOTAT DHE KALIMI I KUOTAVE

Neni 6
Kapitali

- Kapitali i shoqërisë ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin dhënë nga çdo ortak në shoqëri. Çdo ortak zotëron një kuotë të vetme në shoqëri.
- Kapitali aksionar i shoqërisë është **100.000 (njqind mije) lekë** dhe përbëhet nga 1 kuote e vetme.

1. **Zj. Marie CYLAKU, mbajtes i 1 kuote** me vlere 100.000 (njqind mije) Leke., Pjesëmarrja 100 (%).



Neni 7

Mënyra e fitimit dhe kalimit të kuotave.

1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë
 - b) Shitblerje
 - c) Trashëgimisë
 - c) Dhurimit
 - d) Çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj.
2. Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.
3. Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.
Çdo transferim i kuotave tek të tretëtbëhet me vendim të Asamblesë të ortakëve .

Neni 8

Rritja e kapitalit

Shoqëria mund të rrisë Kapitalin Themeltar në para ose në natyrë (pasuritë të luajtëshme apo të paluajtëshme) ose mund të zvogëlojë atë , por jo nën kufirin minimal që lejon ligji Nr.9901 Datë 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”(pjesë për sh.p.k.)

Shtimi ose zvogëlimi i kapitalit bëhet me vendim të Asamblesë së ortakëve të shoqërisë.

Dokumenti depozitohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, e cila bën ndryshimet përkatëse.

KREU III

ORGANET VENDIMARËSE DHE DREJTUESE

NENI 9

Organi Vendimarrës

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Të drejtat dhe detyrimet

1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;

- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat “e” dhe “ë” të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

3. Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretëve, që kanë fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 10

Administrimi

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, i cili caktohet në statut, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve, i cili hyn në fuqi në datën e përcaktuar sipas aktit të emërimit, u kundrejtohet palëve të treta sipas përcaktimeve të nenit 12 të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve emëron Administrator të Shoqërisë dhe përfaqësues ligjor të saj

1. **Zj. Marie CYLAKU**, lindur ne Berat me date 19/10/1985, dhe banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit me nr 034455689 dhe nr.personal I56019063C, madhor me zotesi te plote per te vepruar.
Afati i emërimit 5 vjecar, duke filluar nga data **13/12/2023 deri në datën 13/12/2028**, me të drejtë ripërtëritje.

Asambleja e Ortakëve mund të emërojë një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë pa qenë ortakë të shoqërisë. Afati i emerimit të tyre nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

Në se Asambleja e Ortakëve emëron më shumë se një administrator, ata administrojnë bashkarisht shoqërinë.

Neni 11

Të drejtat dhe detyrimet e administratorit

- Kryen te gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregëtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregëtare.
- Përfaqëson shoqërinë tregëtare ne cdo institucion publik dhe privat, ku shoqeria ka interesa.
- Kujdeset për mbajtjen saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë.
- Përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve,i paraqet këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme të Ortakutëve për miratim.
- Kryen regjistrimin dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë,sic parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- Raporton përpara ortakëve në lidhje me zbatimin e politikave tregëtare dhe realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të vecantë për veprimtarinë e shoqërisë tregëtare.
- Kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- Njofton Ortakët për të marë vendimet përkatëse në rastet kur bilanci vjetor,apo raportet e ndërmjetme finaciare, ekziston rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim, si dhe brenda 2 vjetëve të para të regjistrimit të shoqërisë.
- Administratori,gjatë kryerjes së detyrës së tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për cdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyshme me qëllimin e shoqërisë tregëtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacionit përkatës,veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- Nëse administratori vepron në kundërtshtim me detyrat dhe ligjin, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe të kalojë cdo fitim personal që ai apo çdo person tjetër i lidhur me të kanë përfituar nga këto veprime të parregullta (në përputhje me nenin 98, pika 4 e ligjit).
- Në interesin e mirë të shoqërisë në teresi, administratori duhet t'i kushtojë vëmëndje të vecantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedisin ku ushtron kopetencat që lidhen me ligjin dhe në statut, vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita.
- Të vlerësoje me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendim.
- Të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent ose të mundshëm të interesave personale me ato të shoqërisë.
- Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.



- Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar asamblesë së përgjithshme. Administratori, që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë asamblenë e përgjithshme për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi.
- Nëse asambleja e përgjithshme nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.
- Dorëheqja e administratorit nuk cenon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që administratori ka ndaj saj, sipas këtij ligji .

KREU IV DREJTIMI EKONOMIK

Neni 12

Viti Financiar

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Përrjashtimisht Viti i parë financiar i Shoqërisë fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregëtar shqiptar dhe mbyllet më 31 Dhjetor të po atij viti.

Neni 13

Bilanci i shoqërisë dhe dividenti

- Brenda 6 muaj nga mbyllja e vitit financiar, mbledhja e Asamblesë miraton Pasqyrat Financiare të paraqitur nga Administratori. Pasqyrat Financiare përgatiten në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato mund të përgatiten edhe bazuar në Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar nëse plotësohen kriteret ligjore.
- Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë.
- Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me përqindjen e pjesmarjes në kuotat e zotëruara
- Kufizimet për shpërndarjen e dividendit si dhe çertifikata e aftësisë paguese janë të zbatueshme për shoqërinë sipas kushteve të përcaktuara në Nenin 77 të Ligjit nr 9091, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”
- Shoqëria mund t’u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit: aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.
- Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se



shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 14.3.1, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.

Neni 14

Ekspertët. Auditimi ligjor i llogarive

Shoqëria emëron si ekspertë, persona fizik individë apo shoqëri Auditimi, të pavarur nga shoqëria. Eksperti ka për detyrë të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregëtare të Shoqërisë, atë gjithëvjetorë dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e asamblesë të ortakëve

Procedurat e emërimit dhe shkarkimit të tij kryhen në përputhje me Ligjin nr 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor , organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Rregjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar”, por afati i caktimit të Ekspertit nuk mund të jetë më shumë se 7 vjetë kalendarike nga emërimi i parë.

Neni 15

Pasqyrat Financiare, Miratimi, Depozitimi.

Pasqyrat Financiare vjetore, të cilat përmbajnë; Bilancin kontabël, Pasqyrën e të Ardhurave dhe shpenzimeve, Pasqyrën e fluksit të parave , Pasqyrën e ndryshimeve në kapital si dhe shënimet shpeguese, së bashku me raportin e Audituesit të pavarur apo të shoqërisë Audituese, miratohen mbi bazën e vendimit me shkrim të asamblesë të ortakëve , dhe depozitohen në regjistrin tregëtar , në zbatim të nenit 43 të ligjit nr 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit”.

Neni 16

Prishja dhe likuidimi

Shkaqet e prishjes së shoqërisë

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a) Kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- b) Me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- c) Në rast se objekti bëhet i përealizueshëm përshkaktë mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregëtare;
- d) Në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregëtare”
- e) Në raste të tjera, të parashikuara në statut;
- f) Në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
- g) Për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.

Prishja e shoqërisë, si pasojë e një apo më shumë prej shkaqeve të përcaktuara në shkronjat “a”, “c”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga asambleja e ortakëve me shumicën e parashikuar sipas pikës 1, të nenit 87, të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Në rast mosveprimi të asamblesë së ortakëve për të vendosur prishjen, për shkaqet e përcaktuara në shkronjat “a”, “c”, “d”, dhe “dh”, të pikës 1, të këtij neni, çdo person i interesuar mund, në çdo kohë, t’i drejtohet gjykatës për të konstatuar prishjen e shoqërisë.

Pavarësisht ngaparashikimet e sipërpërmendura, ekzistenca e një a më shumë shkaqeve, të parashikuara nga shkronjat “a”, “c”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, nuk do të ketë si pasojë prishjen e shoqërisë dhe hapjen e procedurave të likuidimit, nëse përpara vendimit gjyqësor të formës së prerë, të përmendur në pikën 3, të këtij neni, shkaku i prishjes është korrigjuar, nëse është e mundshme të korrigjohet, dhe ky korrigjim është publikuar nga shoqëria në regjistrin tregtar, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

Prishja e shoqërisë, si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente për procedurat e falimentimit, kur, në përfundim të këtyre procedurave, të gjitha pasuritë e shoqërisë janë likuiduar për shlyerjen në mënyrë kolektive të detyrimeve ndaj kreditorëve apo kur gjykata kompetente për procedurat e falimentimit vendos rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurisë së shoqërisë për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.

Prishja e shoqërisë si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën “ç”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve të nenit 3/1 të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas neneve 190 deri në 205 të këtij ligji.

Administratorët regjistrojnë prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Nëse prishja e shoqërisë bëhet me vendim gjykate, gjykata, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” ia njofton vendimin Qendrës Kombëtare të Regjistrimeve për regjistrim.

Neni 17

Bashkimi dhe ndarja

Shoqëria, me anë të bashkimit, mund t’i kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ajo themelon.

Shoqëria gjithashtu me anë të ndarjes mund t’i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërive të reja.

Operacionet e përmendura më lart mund të realizohen nëpërmjet shoqërive të formave të ndryshme.

Bashkimi ose ndarja sjell prishjen apo likujdim të shoqërisë që zhduket dhe kalimin e plotë të trashëgimisë së saj te shoqëritë përfituese, në gjendje në të cilën ndodhet kjo trashëgimi në datën e realizimit përfundimtar të operacionit.

Bashkimi ose ndarja sjell njëkohësisht për ortakët e shoqërive që zhduken marrjen e cilësisë së ortakëve të shoqërive përfituese sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e bashkimit ose ndarjes.

Përfaqësuesit ligjorë të shoqërive, të cilat marrin pjesë në bashkim, hartojnë një projekt marrëveshje me shkrim, ku përcaktohen të paktën:

- a) forma, emrat e regjistruar dhe selitë e shoqërive që marrin pjesë në bashkim;
 - b) raporti i këmbimit të kuotave apo aksioneve dhe çdo shumë e pagueshme në para;
 - c) kushtet e ndarjes së kuotave apo aksioneve të shoqërisë përthithëse;
 - ç) data, duke nisur nga e cila zotëruesit e këtyre kuotave apo aksioneve kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e fitimit, si dhe çdo kusht i posaçëm që ndikon në ushtrimin e kësaj të drejte;
 - d) data, duke nisur nga e cila veprimet e shoqërisë që përthithet do të trajtohen nga pikëpamja kontabël si veprime të shoqërisë përthithëse;
 - dh) të drejtat që shoqëria përthithëse u njeh zotëruesve të kuotave, aksioneve, të drejtat e veçanta apo titujt e ndryshëm nga aksionet e shoqërive të përthithura apo çdo masë tjetër e parashikuar në lidhje me ta;
 - e) përparësitë e veçanta, që u jepen administratorëve, anëtarëve të këshillit të administrimit, këshillit mbikëqyrës apo ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ë) pasojat që bashkimi do të ketë ndaj punëmarrësve e përfaqësuesve të tyre, si dhe masat e propozuara për to.
- 2 Përfaqësuesit ligjorë të secilës prej shoqërive, që marrin pjesë në bashkim, hartojnë një raport të hollësishëm, ku shpjegohet marrëveshja e bashkimit dhe përshkruhen bazat ligjore dhe ekonomike për të e, në veçanti, raporti i këmbimit të aksioneve, kuotave apo të drejtave të veçanta. Në raport përshkruhen edhe vështirësitë e veçanta të vlerësimit, të cilat janë hasur. Raporti duhet të përshkruajë edhe pasojat e këtij bashkimi mbi punëmarrësit e shoqërive pjesëmarrëse.
- 3 Çdo shoqëri, që merr pjesë në bashkim, jo më vonë se 1 muaj përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë, për vendimin e përcaktuar në nenin 218 të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar, depoziton pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe publikon në faqen e internetit të shoqërisë, nëse ka, projekt-marrëveshjen dhe raportin e bashkimit, sipas pikës 2 të këtij neni. Pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë e dokumentet publikohen në mënyrë të detyrueshme për të paktën tri vitet e fundit.
- 4 Shoqëritë, që përmbushin kërkesën e pikës 3, të nenit 214, të ligjit të sipër cituar, por që kanë qenë të regjistruara për më pak se tre vjet, paraqesin dokumentacionin sipas pikës 3, të këtij neni, vetëm për vitet që kanë qenë të regjistruara.
- 5 Nëse viti i fundit ushtrimor, të cilit i referohen pasqyrat financiare, të përmendura në pikat 3 ose 4, të këtij neni, është mbyllur në një datë e cila është më e hershme se gjashtë muaj përpara datës së hartimit të projekt-marrëveshjes së bashkimit, atëherë, me përjashtim të rastit kur sipas ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008, “Për titujt”, shoqëria ka hartuar dhe u ka vënë në dispozicion aksionarëve raporte financiare gjashtëmujore, shoqëria harton gjithashtu pasqyra kontabël për gjendjen e shoqërisë në një datë, e cila nuk duhet të jetë më e hershme se dita e parë e muajit të

tretëpërparadatëssëhartimittëprojektmarrëveshjes së bashkimit dhe i publikon ato sipas pikës 3 të këtij neni.

- 6 Përfaqësuesit ligjorë të secilës shoqëri pjesëmarrëse në bashkim duhet të njoftojnë asamblenë e përgjithshme të shoqërisë së tyre, si dhe organet e administrimit të shoqërive të tjera që marrin pjesë në bashkim, më qëllim njoftimin e asambleve të përgjithshme të shoqërive përkatëse në lidhje me çdo ndryshim thelbësor në aktivet dhe pasivet e shoqërisë, nga data në të cilën është hartuar projektmarrëveshja e bashkimit, deri në datat e caktuara për mbledhjet e asambleve të përgjithshme që do të vendosin mbi miratimin e projektmarrëveshjes së bashkimit.
- 7 Detyrimi për hartimin e raportit të përmendur në pikën 2, të pasqyrave kontabël të përmendura në pikën 5, si dhe të njoftimit sipas pikës 6, të këtij neni, mund të përjashtohet me miratimin e të gjithë ortakëve/aksionarëve me të drejtë vote të shoqërive pjesëmarrëse në bashkim.

Raporti i ekspertëve

- 1 Përfaqësuesit ligjorë të shoqërive, që marrin pjesë në bashkim, caktojnë ekspertë të pavarur të licencuar të fushave të ndryshme, për të vlerësuar kushtet e projektmarrëveshjes së bashkimit. Ekspertët mund të caktohen për secilën shoqëri ose në mënyrë të përbashkët për të gjitha shoqëritë, që marrin pjesë në bashkim. Ata caktohen nga gjykata përkatëse, nëse kjo kërkohet nga përfaqësuesit ligjorë.
- 2 Ekspertët hartojnë një raport me shkrim, ku duhet të deklarojnë, ndër të tjera, nëse, sipas mendimit të tyre, raporti i këmbimit të aksioneve/kuotave është i drejtë dhe i arsyeshëm. Në deklaratë ekspertët duhet të shprehen, në veçanti:
 - a) për metodën ose metodat e përdorura për të arritur në raportin e propozuar të këmbimit të aksioneve/kuotave;
 - b) nëse kjo metodë apo këto metoda janë të përshtatshme për rastin në fjalë, duke treguar vlerat e arritura përmes përdorimit të metodës/metodave dhe të japin një mendim për rëndësinë relative të secilës metodë, për të arritur në vlerën e vendosur;
 - c) për vështirësitë e veçanta të vlerësimit, të cilat janë hasur.
 - ç) në rastin e një zmadhimi kapitali, të kryer në kuadër të bashkimit apo ndarjes, me qëllim pagimin e aksionarëve të shoqërive që përthithen apo ndahen, raporti i vlerësimit duhet të përmbajë një përshkrim të hollësishëm të kontributeve në natyrë, si dhe në të duhet të përcaktohen metodat e vlerësimit që janë zbatuar dhe të shprehet nëse vlera e llogaritur sipas kësaj metode i korrespondon të paktën vlerës nominale të aksionit dhe, kur është rasti, edhe primit më të lartë të emetimit të aksionit .
- 3 Ekspertët kanë të drejtë të marrin nga shoqëritë që bashkohen të gjithë informacionin dhe dokumentet përkatëse, si dhe të kryejnë të gjitha hetimet e nevojshme.
- 4 Raporti i ekspertëve depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe publikohet në faqen e internetit, nëse ka, të shoqërive që marrin pjesë në bashkim, të paktën një muaj përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë, në lidhje me vendimin e përcaktuar në nenin 218 të ligjit.
- 5 Përfshirja e ekspertëve, sipas pikave 1, 2, 3 e 4 të këtij neni, mund të përjashtohet nëse të gjithë aksionarët/ortakët e shoqërive që bashkohen japin miratimin.

Miratimi i marrëveshjes së bashkimit

- 1 Projektmarrëveshja e bashkimit prodhon efekte vetëm pasi të jetë miratuar nga ortakët apo aksionarët e të gjitha shoqërive, që marrin pjesë në bashkim. Projektmarrëveshja e bashkimit

miratohet, përkatësisht, në përputhje me shumicën e parashikuar në pikën 1 të nenit 87 dhe pikën 1 të nenit 145 të këtij ligji.

- 2 Kur nga projekt marrëveshja e bashkimit preken të drejtat e aksionarëve/ortakëve të veçantë apo të drejtat, që rrjedhin nga aksione të kategorive të veçanta, atëherë projekt marrëveshja i nënshtrohet, sipas rastit, miratimit të ortakëve apo aksionarëve të prekur, ose një votimi të veçantë, i cili merret me shumicën e tre të katërtave të votave të secilës kategori aksionesh të prekura.
- 3 Secili aksionar apo ortak i shoqërive, qëmarrin pjesë në bashkim, ka të drejtë të kërkojë e të marrë nga shoqëria, pa pagesë, kopje të plotë apo të pjesëshme të dokumenteve, në bazë të të cilave kryhet bashkimi, sipas neneve 216 dhe 217. Nëse aksionari apo ortaku ka pranuar kryerjen e njoftimeve nga shoqëria në formë elektronike, këto dokumente mund t'i dërgohen me postë elektronike.
- 4 Shoqëria do të përjashtohet nga detyrimi për të mbajtur në dispozicion në selinë e saj dokumentacionin që duhet t'u jepet ortakëve apo aksionarëve, sipas pikës 3, nëse për një periudhë të pandërprerë, e cila nis një muaj përpara datës së caktuar për mbajtjen e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme për miratimin e projekt marrëveshjes së bashkimit, ky dokumentacion u vihet në dispozicion ortakëve apo aksionarëve, pa pagesë, për t'u parë, shkarkuar apo për të marrë kopje në formë shkresore në faqen e internetit të shoqërisë. Për çdo ndërprerje të përkohshme të mundësisë për të hyrë në faqen e internetit të shoqërisë, për arsye teknike apo arsye të tjera, afati njëmuajor i publikimit ndërpritet dhe rinis nga e para në momentin kur faqja e internetit të shoqërisë bëhet sërish e arritshme.

Neni 18

Shoqëria mund të lidhë kontrata për tregëtimin dhe shërbimet që ajo kryen në përputhje me objektin e veprimtarisë së saj; me sektore shtetërore, drejtpërdrejt në tregun e lirë, si dhe me persona Juridike e Fizike vendas ose të huaj.

Neni 19

Në veprimet kontraktuale shoqëria përfaqësohet nga Administratori i saj.

Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontrata janë të detyrueshme për Shoqërinë.

Neni 20

Shoqëria përgjigjet për kontributin fiskal, afatet e derdhjes së tij, sigurimet shoqërore etj. Ajo ka të drejtë të çelë llogari likujduese pranë Bankave të vendit dhe të kryejë veprimet likujduese nëpërmjet tyre.

Urdher xhirimet për trasaksionet financiare do të jenë të vlefshme vetëm nëse janë të nënshkruara nga administratori i shoqërisë.

Neni 21

Për sigurimin e veprimtarisë ekonomike shoqëria ka të drejtë të vetfinancohet, të marrë hua në banka apo institute të kreditit, në lekë ose në valute të huaj. Shkëmbimin e monedhës shqiptare në monedhë të huaj dhe anasjelltas mund ta bëjë në përputhje me kursin e caktuar nga Banka e Shtetit Shqiptar, ose në tregun e lirë privat të valutes.



Neni 22

Për pasqyrimin e aktivitetit, administratori ose persona të tjerë të caktuar prej tij, janë të detyruar të mbajnë dokumentacionin e rregullt financiar dhe regjistrat përkatës sipas kërkesave të legjislacionit.

KREU V MARRËDHËNIET E PUNËSIMIT

Neni 23

Asambleja e Ortakëve vendos për shtimin ose pakësimin e numrit të administratorëve dhe personave të tjerë të punësuar në veprimtarinë e Shoqërisë

Neni 24

Marrëdhëniet e punësimit brenda Shoqërisë rregullohen sipas kontratës së punës që lidhet midis palëve, në përputhje me Legjislacionin shqiptar. Marrja në punë bëhet nga punëdhënësi, në përputhje me kërkesat e Kodit të Punës .

Neni 25

Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punës të punmarësve bëhet në bazë të një akti me shkrim të leshuar nga administratori. Largimi lidhet me mbarimin e Kontratës së Punës, për shkak të shkeljeve disiplinore ose me kërkesën e të interesuarit. Mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim të palëve . Kur mirëkuptimi s’është i mundur, palët i drejtohen Gjykatës së Rrethit që ka kompetencat territoriale dhe lëndore.

KREU VI TË PËRGJITHSHME

Neni 26

Baza ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me statusin e saj dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ;
- Kodi Civil ;
- Ligji Nr.9901 Datë.14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare “, i ndryshuar
- Ligji 131/2015“Për Qendrën Kombëtare të Bisnesit”,
- Ligji Nr.9228, Datë.29.4.2004, “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

Neni 27

Mosmarrëveshjet

Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe cdo mosmarrëveshje që mundet të lindë midis shoqërisë dhe të tretëve do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.



Neni 28

Dispozita Përfundimtare

Ky Statut u redaktua në 4 ekzemplarë me përmbajte dhe vlera të njejta juridike, në gjuhën shqipe dhe pasi u lexua në gjuhën shqipe, miratohet në parim dhe nen për nen nga ortakët themelues të shoqërisë tregëtare, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin dhe firmën origjinale .

Neni 29

Hyrja në fuqi

Ky Statut hyn në fuqi dhe është i detyrueshëm për zbatim në momentin e firmosjes nga ortakët, sot më datë 13/12/2023.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË

“A R S I”

Zj. Marie CYLAKU

Marie Cylaku

